



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË

Datë 02.06.2025



Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, u mbajt këtë fundjavë, për të dytin vit rradhazi në këtë institucion, konkursi midis Fakulteteve të Drejtësisë së Universiteteve të Republikës së Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.

Ky projekt i i organizuar nga “Halimi Foundation Institute”, u mbështet nga Ambasada e Hollandës dhe nga Këshilli i Europës, si dhe me mbështetjen teknike të televizionit A2CNN, i cili do t’i transmetojë këto seanca javët e ardhshme.

16 grupet pjesmarrëse zhvilluan gjyqe imituese me trupë gjykuese të përbërë prej :

Ditën e parë

Këshilltare Ligjore Aulona Bodo - në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë Fejzulla
Prof.Asoc.Dr. Fejzulla Berisha - profesor/akademik në Republikën e Kosovës dhe asaj të
Maqedonisë së Veriut

Gjyqtar Bekim Mehmedi -Kryetar i Gjykatës së Apelit Gostivar.

Ditën e dytë

Gjyqtar Gerd Hoxha - Z/Kryetar Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm
Tiranë

Prof.Asoc.Dr. Fejzulla Berisha - profesor/akademik në Republikën e Kosovës dhe asaj të
Maqedonisë së Veriut

Gjyqtar Bekim Mehmedi - Kryetar i Gjykatës së Apelit Gostivar.

Në sfidën finale, u përballen Universiteti i Vlorës dhe Universiteti Luarasi, ku pas një gare të fortë, fitues u shpall Univeristeti i Vlorës.

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E

JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË







